



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2018**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Mungoi: Sami Istrefi**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës – z.Besim Muzaqi, përfaqësues të delegacionit nga Komuna Växjö- e Suedisë, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga kuvendi që të mbahet një minutë heshtje, për vdekjen e ish-kryetarit të komunës dhe veprimtarit të shquar z. Hajzer Krasniqi.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - njoftoi kuvendin se gjatë pauzës së mbledhjes do të ngushëllohet familja e Hajzer Krasniqit dhe për këtë ftoi anëtarët e kuvendit që t'i bashkëngjiten ngushëllimeve.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e katërt e rendit të ditës, “emërtimi i sheshit Ahmet Krasniqi”, kjo për arsye se propozimi nuk kishte arsyeshmëri të qartë, për faktin se nuk dihet ku janë kufijtë e këtij sheshi. Andaj tutje ai arsyetoi se në propozimin e drejtorisë nuk dihet a do të jetë i rrethuar objekti i hamamit, si dhe a do të jetë i rrethuar objekti i komunës. Në fund ai tha se për këtë temë duhet të mblidhen të gjitha partitë politike të përfaqësuara në kuvend dhe kështu të gjendet një zgjidhje që është e përshtatshme dhe për këtë të kemi një konsensus të të gjithëve.

**Bahrije Ademi, anëtare e kuvendit** - e mbështeti propozimin e parafolësit të saj, që pika lidhur me sheshin “Ahmet Krasniqi” të hiqet nga rendi i ditës, pasi që kjo pikë duhet të analizohet, pasi që me ligj është e përcaktuar që largësia apo distanca e një objekti të radhës me objektet e trashëgimisë kulturore, duhet të jetë 50 metra. Andaj në fund propozoi që kjo

pikë të analizohet dhe në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të ofrohet para kuvendit, me qëllim që të evitohet ndonjë shkelje ligjore eventuale.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – tha se për këtë pikë nuk kemi konsultimet e duhura paraprake, dhe kjo pikë si e tillë duhet të shtyhet në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit. Lidhur me këtë duhet të caktohen kufijtë e këtij sheshi. Pastaj ceku se nuk duhet të vihen në lajthitje anëtarët e kuvendit, pasi me këtë preket sheshi “Hasan Prishtina” dhe kjo është e papranueshme, për faktin se me këtë vendim preken figurat kombëtare. Në fund tha se kjo çështje duhet të analizohet dhe të dihen kufijtë e këtij sheshi, kurse lidhur me pikën për ofrimin e ndihmës financiare kërkoi që ajo pikë të futet në rend të ditës pasi kemi të bëjmë me një rast të ndjeshëm.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se nuk është mirë që figura e Ahmet Krasniqit të politizohet, sepse dihet se çfarë figure ka qenë, që pas Hasan Prishtinës, është figura më emblematike e komunës sonë dhe më gjerë. Andaj vlerësoi se nuk ka asgjë të keqe nëse bashkohet sheshi “Hasan Prishtina” me sheshin “Ahmet Krasniqi”, sepse janë dy figura më emblematike të historisë që ka pasur Vushtrria ndonjëherë.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – propozoi që pika e katërt e rendit të ditës lidhur me emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi”, të hiqet nga rendi i ditës, pasi kjo pikë e rendit të ditës nuk është e analizuar si duhet dhe kufijtë e sheshit nuk janë të përcaktuar saktë. Pastaj ai vlerësoi se Ahmet Krasniqi, është një figurë e dëshmuar kombëtare dhe nuk duhet të tentohet të politizohet figurat kombëtare.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se e mbështet mendimin që figura e Ahmet Krasniqit në asnjë formë të mos politizohet, kur dihet fakti se ai është vrarë me flamurin e UÇK-së dhe atë kombëtar, për figurën e tij nuk ka dyshime dhe ai do të mbetet një figurë kombëtare e jona. Tutje lidhur me këtë çështje ai vlerësoi se pajtohet që kjo çështje të shtyhet për ndonjërin nga mbledhjet e radhës pasi të bëhen vlerësimet dhe analizat e duhura konform gjendjes faktike.

**Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit** – tha se ky propozim ka marrë aprovimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe shtoi se emërtimi i një sheshi me emrin e Ahmet Krasniqit është mjaft i qëlluar kur dihet kontributi i tij si një figurë emblematike.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se figura e Ahmet Krasniqit është figurë emblematike, pasi që edhe familja e tij ka dhënë një kontribut të çmuar për çështjen kombëtare. Por vlerësoi se kur bëhet fjalë për emërtimin e shesheve duhet të jemi të kujdesshëm sepse ka vërejtje sa i përket emërtimit të rrugëve për faktin se kur bëhet fjalë për figura të rëndësishme, atëherë edhe emërtimi me emrin e tyre duhet të bëhet për ndonjë rrugë të rëndësishme.

*Në fund të diskutimeve lidhur me pikën e katërt të rendit të ditës, kuvendi me 19 vota “për, 13 vota “kundër” të tjerat abstenuan vendosi që të hiqet nga rendi i ditës pika lidhur me emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi”.*

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - njoftoi kuvendin lidhur me një kërkesë për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Fevzije Shkrelin, e cila i është adresuar kryesuesit të kuvendit. Për këtë ai vlerësoi se kjo kërkesë nuk i ka kaluar filtrat e nevojshëm dhe propozoi që kjo pikë të shtyhet për ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të bëhen sqarime lidhur me kërkesën për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Fevzije Shkrelin. Mandej ai shfaqti idenë që kjo familje të përkrahet pasi që gjendja e saj është e rëndë.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - dha sqarime lidhur me kërkesën e Fevzije Shkrelit, duke e lexuar kërkesën para anëtarëve të kuvendit.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - paraqiti sqarime lidhur me kërkesën në fjalë, duke shtuar se çështja e ndërtimit të shtëpisë është kategori buxhetore që lidhet me bashkëfinancim dhe si kod ekonomik është e përfshirë në Drejtorinë e Shëndetësisë. Tutje shtoi se kjo kërkesë i

ka arritur me vonesë dhe se e njëjta nuk i ka kaluar filtrat e nevojshëm. Komuna njoftoi se nuk bën ndërtimin direkt të shtëpive veçse ato i ndërton në kuadër të bashkëfinancimit me donatorë. Në fund ai tha se është mirë që të përkrahet familja në fjalë, por paraprakisht duhet të kemi një verifikim dhe një pasqyrë të qartë lidhur me këtë familje dhe duke verifikuar se familja në fjalë a posedon pronë të veten dhe kjo duhet të verifikohet nga komisioni i komunës.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – tha se nuk është mirë që në kësi lloj formash të sfidohen dhe të vihen në lajthitje anëtarët e kuvendit pasi që kjo kërkesë është proceduar nga kryesuesi i kuvendit përmes Sekretarisë së Kuvendit dhe bëhet fjalë për një rast të ndjeshëm ku anëtarët e kuvendit nuk mund të votojnë për heqjen nga rendi i ditës i kësaj pike.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – tha se kërkesat për ofrimin e ndihmës financiare procedohen përmes apo nga Drejtoria e Shëndetësisë, andaj në këtë rast nuk është mirë që të sfidohen anëtarët e kuvendit gjoja se ata nuk janë në përkrahje të kësaj kërkesë. Pastaj ai vlerësoi se kjo kërkesë është dashur të kalojë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe të shikohet aspekti financiar se a ka mjete të mjaftueshme për realizimin e kësaj kërkesë.

*Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës kuvendit pas votimit me 29 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:*

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 31.05.2018;
2. Shqyrtimi i Draft-Kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për miratim të nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin-funksionalizimin e Qendrës për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përkrahjen financiare për botimin e librit “Trashëgimia arkeologjike e Komunës së Vushtrrisë”;
6. Shqyrtimi i Draft-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018 (**shqyrtimi i parë**);
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Administratë;
9. Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës;
10. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e analizës teknike lidhur me pikat e grumbullimit të mbeturinave (shqyrtimi i dytë);
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kthimin e mjeteve financiare Komisionit Evropian.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 31.05.2018;**

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 31.05.2018.*

**2. Shqyrtimi i Draft-Kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021**

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – tha se Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021, është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm për planifikimin e buxhetit të komunës dhe për caktimin e prioritetëve strategjike komunale në zhvillimin e komunës. Tutje ai duke iu referuar fushës së shëndetësisë propozoi që objekti shëndetësor i ndërtuar afër spitalit të qytetit

t'i kalojë Ministrisë së Shëndetësisë ku kjo do të mund të bëhej me një marrëveshje mes komunës dhe ministrisë, pasi që ai objekt nuk i plotëson standardet për një objekt shëndetësor. Në këtë kontekst ai vlerësoi se ky objekt mirë do të ishte t'i kalojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe kjo e fundit të financojë ndërtimin e një objekti të ri sipas standardeve. Për realizimin e këtij projekti do të duhet të gjendet një lokacion i përshtatshëm dhe i cili është i qasshëm për qytetarët. Andaj për këtë kërkoi që drejtorja gjegjëse dhe kryetari i komunës të zhvillojnë negociata me Ministrinë e Shëndetësisë në gjetjen e mjeteve për realizimin e këtij projekti.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar faqes 12 të dokumentit ku bëhet fjalë për grantin specifik të arsimit në ç' rast formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm duke marrë për bazë, si dhe duke u bazuar në udhëzimin administrativ 22/2013 hartuar nga MASHT-i ku thuhet se raporti nxënës-mësimdhënës duhet të jetë 1/21 e që i bie që raporti është 21 mësimdhënës e 1 nxënës e që duhet të jetë e kundërta, dhe shpreson se është ndonjë gabim teknik, por duhet të jemi të kujdesshëm pasi që komuna është institucion serioz ku nuk guxon të bëjë gabime të tilla. Mandej kërkoi sqarime sa i përket shërbimit profesional për 255 pedagogë ku pyeti se ku do të punojnë këta pedagogë. Në fund pyeti se për cilat profile do të ketë zhvillim të praktikës në shkollën profesionale.

**Abit Abiti, ZKF** - paraqiti sqarime profesionale lidhur me Draft-Kornizën afatmesme buxhetore për vitet 2019-2021, duke dhënë përgjigje për anëtarët e kuvendit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovet Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2019/01, e lëshuar nga Ministria e Financave me të cilën caktohen kufijtë buxhetorë të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019-2021.**

**2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**3.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.**

**3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për miratim të nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se si subjekt politik e përkrahin nismën për ndryshimin e Statutit të komunës dhe përgëzoi qeverinë komunale për arsyetimin e prezantuar në kuvend.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** - tha se edhe në të kaluarën, por edhe tani është i pajtimit që në kuadër të ndryshimit të Statutit të komunës të bëhet ndarja e disa drejtorive komunale si p.sh ajo e shëndetësisë nga mirëqenia sociale, por që edhe disa drejtori tjera të shuhen. Në fund tha se është me rëndësi që të ngriten kapacitetet nëpër drejtori dhe jo vetëm të bëhet emërtimi i drejtorëve të caktuara.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës, 02 Nr.799-1/18 e datës 8.6.2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01nr. 58/11, datë 28.4.2011.**

**2.Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të komunës do t'i hartojë komisioni i cili formohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.**

**3.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**Në vazhdim kuvendi me vota unanime miratoi çelësin prej 5 anëtarësh për formimin e komisionit për ndryshimin e Statutit të komunës.**

**Pas dhënës së propozimeve nga anëtarët e kuvendit dhe qeveria komunale Kuvendi me vota unanime themeloi komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës në këtë përbërje:**

**1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:**

**1.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit (AKR);**

**1.2 Safet Idrizi, anëtar i kuvendit (PDK);**

**1.3 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (koalicioni LDK, LVV, AKR, AAK dhe Nisma);**

**1.4 Idriz Muzaqi, (shëf i shërbimit juridik në QKMF);**

**1.5 Haki Maloku, (zyra e kryetarit).**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i cili ka për obligim që t'i hartojë ndryshimet statutare dhe të njëjtat duhet t'ia ofrojë Kuvendit të komunës për aprovim.**

**4.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelim-funksionalizimin e Qendrës për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se parimisht janë që kjo qendër të funksionalizohet sa më parë, por shtoi se ky propozim-vendim është në kundërshtim me ligjin, për faktin se pika e katërt e propozimit ku jep mundësinë që ndonjë OJQ-je t'i jepet e drejta e shfrytëzimit dhe menaxhimit të asaj qendre pa pëlqimin e kuvendit, lë mundësinë për malaverzime të ndryshme dhe kjo nuk duhet lejuar, andaj për këtë propozoi që pika e katërt e këtij propozimi të hiqet. Në fund tha se për këtë duhet të merret mendimi i zyrës ligjore.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - tha se e mbështet mendimin e parafolësit të tij dhe ceku se kjo qendër duhet të futet nën kompetencat e komunës dhe jo të lihet në dorën e ndonjë organizate joqeveritare.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - paraqiti vërejtjet e tij sa i përket lokacionit të ndërtimit të kësaj qendre dhe shtoi se nëse qeveria e kaluar e ka parë të rëndësishme funksionalizimin e kësaj qendre, pse atëherë nuk ka ndarë mjete për këtë qëllim. Tutje shtoi se ky vendim është mjaft i qartë dhe vlerësoi se nëse kuvendi do të vendoste që ndonjë OJQ-je do t'i jepej e drejta për funksionalizimin e kësaj qendre, atëherë kjo do të ishte e mirëseardhur për faktin se mbajtja e kësaj qendre ka një kosto të lartë financiare.

**Qërim Selimi, anëtar i kuvendit** - tha se funksionalizimi i kësaj qendre do të mund bëhet nga kapacitetet brenda komunës dhe atë me një vendim të drejtorisë kompetente, dhe kjo do të ishte ide më e mirë sesa kjo çështje t'i lihet në dorë ndonjë organizate.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të respektohet ligji, statuti dhe rregullorja e punës së kuvendit ku caktohen rregullat lidhur me debatin në foltore të kuvendit dhe jo që sa herë që dikujt i kujtohet diçka të dalë dhe të mund ta marr fjalën në foltore.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** - tha se një OJQ nuk do të mund të menaxhojë këtë qendër, por komuna duhet të ketë bashkëpunim sa i përket menaxhimit të kësaj qendre. Në fund bëri apel që kjo qendër të vihet në funksion sa më shpejt që të jetë e mundur.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** - tha se është shumë e nevojshme të merret mendimi i zyrës ligjore lidhur me këtë temë, dhe shtoi se duhet të hulumtohet që të gjenden mjete financiare qoftë në ndonjë ministri apo në ndonjë OJQ apo donatorë tjetër që kjo qendër të vihet në funksion sa më parë.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë së kryetarit** - paraqiti sqarime sa i përket anës ligjore të funksionalizimit të kësaj qendre, duke shtuar se ekzistojnë dy mënyra të dhënies se kësaj prone në shfrytëzim dhe atë që komuna të ndajë mjete financiare për funksionalizimin e kësaj qendre dhe kjo qendër të futet nënkompetencat e komunës dhe forma tjetër është përmes dhënies se kësaj prone në shfrytëzim përmes konkurrencës sipas Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - tha se nuk e kupton se përse gjithë ky skepticizëm sa i përket investimeve nga OJQ-të. Lidhur me këtë ai ceku se mungesa e mjeteve financiare të komunës e vështirëson funksionalizimin e kësaj qendre, andaj dhënia në shfrytëzim ndonjë organizate do të ishte ide e mirë dhe do të mundësonte funksionalizimin e kësaj qendre. Në fund pyeti eksponentët e qeverisjes së kaluar se si e kanë menduar funksionalizimin e kësaj qendre pasi që nuk kanë planifikuar mjete financiare.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** - tha se është mirë që është përfunduar projekti për ndërtimin e kësaj qendre. Tutje shtoi se pika 3 dhe 4 e propozim-vendimit duhet të hiqet dhe kjo qendër të futet nën autoritetin e komunës, dhe në këtë kontekst ajo vlerësoi se kjo nuk nënkupton në asnjë formë mungesën e bashkëpunimit me OJQ-të, porse kjo do të mundësohet përmes koordinorit që do të emërohet nga komuna.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se nëse gjendet ndonjë OJQ, e cila do të financonte këtë qendër, atëherë pse mos të lejohet kjo formë e financimit pasi që kështu do të lirohej barra ndaj buxhetit të komunës. Pastaj ai vlerësoi se koordinatori i emëruar nga komuna për këtë projekt do të mbikëqyrë punët në këtë qendër dhe nëse gjen se ka shkelje OJQ-së do të mund t'i merrej e drejta e menaxhimit të kësaj qendre.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 4 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

- 1. Me këtë vendim themelohet-funksionalizohet Qendra për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc.**
- 2. Obligohet Kryetari i komunës të emërojë një koordinator për funksionalizimin dhe menaxhimin e qendrës nga pika 1 e këtij vendimi.**
- 3. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, autorizohet që të angazhohet dhe komunikojë me OJQ-të e fushës përkatëse dhe institucionet tjera (Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të funksionalizimit të kësaj qendre.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**
- 5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përkrahjen financiare për botimin e librit “Trashëgimia arkeologjike e Komunës së Vushtrrisë”**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se e përkrah këtë propozim për përkrahje financiare për botimin e këtij libri, por shprehu vërejtjet e tij sa i përket zhvillimit të procedurave. Në këtë kontekst ceku se edhe përkundër faktit që mjetet janë propozuar nga kategoria e subvencioneve, por në këtë formë askush nuk ka të drejtë të ndajë mjete financiare nga buxheti publik sipas vullnetit dhe tekave të tij. Duke iu referuar Ligjit të Prokurimit ceku se edhe në këtë rast është dashur të kemi konkurrencë dhe të ofertojmë ashtu që oferta më e mirë të përfitojë. Në këtë relacion vlerësoi se Ligji i Prokurimit Publik ofron modalitete, të cilat mundësojnë që mjetet të ndahen në formë ligjore p.sh duke u përdorur modalitetit i prokurimit të negociuar. Në fund tha se kjo çështje është dashur të filtrohet mirë në zyrën ligjore dhe vetëm pas kësaj të sillet në kuvend dhe jo kështu të sfidohen anëtarët e kuvendit.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se edhe përkundër vlerës që ka ky libër, prapëseprapë mendon se vlera financiare e propozuar vetëm për botimin e këtij libri është jashtëzakonisht e lartë. Në vazhdim vlerësoi se pavarësisht vlerave dhe rëndësisë që ka ky libër kapacitetet e komunës janë të kufizuara, andaj propozoi që shumica financiare e propozuar të zbritet dhe ajo të jetë 1000 €. Pastaj ceku se mbështetja e kuvendit duhet të jetë konform propozimeve që janë bërë më herët nga ana e kuvendit dhe ato duhet të jenë të arsyeshme për faktin se është e padrejtë që dikush të mbështetet shtatëfish më shumë sesa të tjerët që janë mbështetur më herët.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - tha se hartimi i këtij libri është një projekt i rëndësishëm për komunën, mirëpo të bëhet ky libër nga njerëz jashtë komunës sonë kjo është një nënçmim për komunën tonë dhe për njerëzit tanë. Pastaj ai vlerësoi se kjo shumë e mjeteve financiare është jashtëzakonisht e lartë dhe e papërbalueshme për komunën, dhe për këtë kërkoi që kjo kërkesë të hedhet poshtë nga ana e kuvendit. Në fund tha se nëse vendoset që kuvendi të ndajë mjete financiare, atëherë ajo vlerë duhet të jetë simbolike dhe në të njëjtën kohë autori duhet të kushtëzohet deri në botimin e librit dhe atëherë t'i derdhen mjetet financiare.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se si grup kuvendar e mbështesin propozimin e nënkryetarit të komunës dhe shtoi se edhe përkundër rëndësisë së kësaj vepre, mundësitë buxhetore të komunës janë të limituara, andaj propozoi që kjo shumë e mjeteve monetare të zbritet në 1000 €.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim aprovohet kërkesa me nr. 03-104/02-0016166/18, e datës 04.04.2018, për përkrahjen financiare për botimin e librit të Enver Rexhës, në shumë prej një mijë (1000.00) Euro.**

**2. Obligohet autori i këtij libri që tridhjetë (30) ekzemplarë të këtij libri t'ia dhurojë bibliotekës të qytetit të Vushtrrisë.**

**3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**6. Shqyrtimi i Draft-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018 (shqyrtimi i parë)**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018.**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 5 korrik 2018 dhe zgjat deri më 25 korrik 2018.**

**3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerrë masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4.Obligohet Zyra e informimit që si propozues i draft-planit në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-planit në fjalë në mbledhjen e kuvendit në muajin korrik 2018.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**7.Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë**

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - pasi e përgëzoi për punën e mirë Drejtorinë e Inspektimeve, shtoi se duhet të ketë kujdes të veçantë pasi që puna në këtë dikaster është sa e rëndësishme aq edhe ndjeshme, për funksionimin sa më të mirë të jetës së qytetarëve tanë si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin qendror. Tutje ajo adresoi disa shqetësime të qytetarëve duke cekur se shqetësim konkret është zënia e trotuareve me produkte ushqimore nga ana e bizneseve të ndryshme, ku kështu vështirësohet lëvizja normale e qytetarëve në qytet. Shqetësim më i veçantë është ekspozimi i produkteve ushqimore dhe pijeve të cilat nuk guxojnë t’i ekspozohen as dritës e as diellit, për faktin se këto mund të kanosin rrezikun për ndonjë sëmundje që lidhen me ushqimin. Shqetësimi tjetër është mosrespektimi i orarit zyrtar të punës nga ana e barnatoreve të qytetit, të cilat punojnë jashtë orarit në kohën kur barnatoret e caktuara janë kujdestare dhe ato punojnë kot kur edhe barnatoret tjera janë duke punuar jashtë orarit të punës të përcaktuar me rregullore.

**8.Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Administratë**

**9.Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës**

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se është mirë që drejtoria përkatëse të verifikojë se sa prona posedon, ku gjenden ato prona, nga kush shfrytëzohen dhe për këtë të hartojë një raport të cilin duhet t’ia adresojë kuvendit të komunës.

**10.Të ndryshme.**

**a).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e analizës teknike lidhur me pikat e grumbullimit të mbeturinave (shqyrtimi i dytë)**



**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim aprovohet Analiza teknike e pikave të grumbullimit të mbeturinave.**

**2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektimeve.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kthimin e mjeteve financiare Komisionit Evropian**

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** - kërkoi sqarime nga Zyrtari kryesor financiar lidhur me propozimin për kthimin e mjeteve financiare Komisionit Evropian.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - njoftoi kuvendin se kjo çështje lidhet me një marrëveshje bashkëpunimi mes komunës sonë dhe Bashkimit Evropian për krijimin e një platforme ekonomike të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave, ku ka përfshirë një vlerë financiare për më tepër se 500 mijë euro, shprehur në përqindje këtë projekt e kishte financuar Bashkimi Evropian në vlerë prej 90 %, kurse komuna në vlerë prej 10 %. Mirëpo në saje të disa lëshimeve Bashkimi Evropian i ka kërkuar Komunës së Vushtrrisë 18,113.51 €, që t'i kthehen në llogari dhe për këtë jemi të obliguar të merret vendimi nga ana e kuvendit. Lidhur me këtë problematikë bëri të ditur se është njoftuar edhe prokuroria e shtetit, dhe vlerësoi se me qëllim të ruajtjes së raporteve me Bashkimin Evropian jemi obliguar që këtë çështje ta sjellim në kuvend për aprovim.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – tha se është mirë që të sqarohet kuvendi, por edhe opinioni lidhur me këtë çështje për faktin se 18.000.00 € nuk janë pak dhe se me këtë duhet të merret hetuesia dhe prokuroria duke u konstatuar se kush ka qenë menaxher i këtij projekti dhe se në çfarë forme ishin bërë ato pagesa pa mbulueshmëri të dokumentacionit.

**Abit Abiti, ZKF-** paraqiti sqarime profesionale lidhur me çështjen në fjalë duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit, ku ceku se auditori ka gjetur se disa pagesa janë kryer si të pasafatshme dhe për këtë është kërkuar kthimi i këtyre mjeteve në llogarinë e Komisionit Evropian.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – pyeti se përse është e nevojshme që këtë vendim ta marr kuvendi, dhe shtroi dilemën se ndoshta dikush po dëshiron t'i ikë përgjegjësisë duke u fshehur prapa vendimeve të kuvendit, për faktin se pushtetet janë të ndara dhe kryetari i komunës bashkë me drejtorin gjegjës, në saj të kompetencave të tyre kanë të drejtë të marrin vendim për këtë çështje.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se buxheti për vitin 2018 është aprovuar nga kuvendi i kaluar i përgatitur nga qeveria e kaluar, dhe ky shpenzim që tani duhet ta aprovojmë nuk ka qenë i planifikuar në buxhet sepse ka dal si shpenzim i paplanifikuar dhe si i tillë është specifik dhe për këtë nevojitet aprovimi i kuvendit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 23 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet kthimi i mjeteve financiare Komisionit Evropian në vlerë prej 18,113.51 €, nga projekti “Bashkëfinancim me donatorë” në kuadër të Drejtorisë për**

Shërbime Publike, me kod të programit 18184, sipas DEBIT NOTE me Nr.3241801144 të parashtruar nga Komisioni Evropian më datë 28.5.2018.

2. Autorizohet Drejtoria për Shërbime Publike që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për kthimin e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - parashtror një kërkesë të një banori të fshatit Dolak, Gani Kelmendi, i cili dikur kishte një kioskë afër shtëpisë së mallrave dhe me privatizimin e kësaj ndërmarrjeje kioska i është larguar nga aty, andaj tani ai gjenet në një situatë jo të mirë ekonomike ku edhe kërkon që t'i jepet mundësia për një hapësirë për vendosjen e kësaj kioske. Kjo kërkesë i adresohet Drejtorisë së Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Pastaj ai adresoi edhe një kërkesë tjetër të parashtruar nga klubi i shahut të cilët ankohen se nuk kanë mbajtur gara gjatë këtij viti si rezultat i mungesës së mjeteve monetare, andaj kërkojnë nga Drejtoria e Kulturës që të merr për bazë kërkesat e tyre. Në fund ceku se sportisti i kikkoksit Lutfi Menxhiqi, ka pasur shumë suksese në gara dhe ai duhet të mbështetet me subvencione.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - adresoi shqetësimin e saj për ngritjen e çmimeve të disa shërbimeve dhe të disa produkteve, dhe kjo është bërë në mënyrë të dakorduar prej secilit shërbimdhënës dhe secilit shitës, si dhe kjo ngritje e çmimeve po ndodh vetëm në komunën tonë dhe është duke zgjuar shqetësim të madh tek qytetarët.

**Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit** – adresoi disa kërkesa të banorëve të fshatit Smrekonicë ku e para është shqetësimi i banorëve lidhur me kanalizimin e shkollës fillore i cili derdhet tek lagjja “Berisha” dhe në këtë lokalitet është vështirësuar jetesa për shkak të kundërmimit nga ky kanalizim, kurse lidhur me këtë problematikë kërkoj që të merret Drejtoria e Arsimit. Ndërsa shqetësimi tjetër lidhet me gypin e ujësjellësit në fshatin Smrekonicë, ku në muajt e fundit të vitit të kaluar kishte filluar rregullimi i kanalizimit në ç’rast është rregulluar linja kryesore dhe disa degëzime nëpër fshat, por më tutje çfarë ndodhi është brengë e qytetarëve që nuk dinë për faktin se kompania e cila punoi në këtë projekt përveç dëmeve që i shkaktoi në rrugicat e fshatit, ajo e mori materialin dhe u largua nga aty, kurse problemet e qytetarëve mbetën të pazgjidhura.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** - paraqiti shqetësimin e banorëve të fshatit Stanoc lidhur me ndërtimin e një ure për të cilën ishte premtuar edhe më herët se do të ndërtohet, por akoma ky projekt nuk është realizuar, kështu që ai apeloj që të futet në planifikim dhe të realizohet ky projekt.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – pyeti drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, se kryetari i komunës a e shfrytëzon beneficinin për telefon dhe për kafe, kjo përgjigje duhet të ofrohet me shkrim.

Mbledhja përfundoi në ora 13:55.

**Bastri Duraku**

  
Procesmbajtës

**Nasuf Aliu**

  
Kryesues i Kuvendit